



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E PESTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **21.06.2022 (e Martë)** në zyrën e konferencave të objektit e vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani,znj. Liridona Bislimi. Munguan z.Jakup Demiri, znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 5 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për të gjithë ju anëtarë të KPF-së, nënkryetar, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje, mirë se keni ardhur në mbledhjen e peste të rregullt të KPF-së për këtë vit! Desha të ju njoftoj se shumicën e aktet që i kemi miratuar kanë marr ligjshmërinë nga ana e MAPL-së, përveç një vendimit ende nuk e kemi pranuar konfirmimin e ligjshmërisë. A ka dikush jashtë rendit të ditës ju lutem?

**z.Ramadan Deliu:** Drejtoreshë, a keni bërë najsën me qet vendimin në Kabash, që e kemi shfuqizuar.

**znj.Majlinda Ostergllava:** Do të shikojmë mundësinë t'ij drejtohem Agjencisë Kadastrale të Kosovës me kërkun mu rregullu kjo çështje, me kërkun korrigjim të kësaj, sepse aty nuk ka lum.

**znj.Liridona Bislimi:** Përshëndetje për të gjithë! Unë kam mi diskutu dy çështje. Kryesues, në mandatin e kalum kemi qenë së bashku në opozitë, edhe e dimë që dytë kemi qenë njëzëri për me punu me komisionin për emërimin, riemërimin e rrugëve. Po du me tu drejtu ty, që ato kërkesa të qytetarëve të Komunës së Vitisë sa i përket emërtimin të rrugëve, riemërtimin, rrugët e reja vetëm që janë tu shku tu rrit. Kam shpresu që me ka me shku kaq gjatë që në të bëhet komisioni. Besoj që është një çështje shumë me rëndësi dhe të vendoset me prioritet, prandaj kërkuj që të formoni komisionin. Çështja tjetër është që me u vendos si propozim ose si pikë e rendit të ditës për diskutim. Është tema që e kemi përmend edhe me herët, që është diskutu si temë shume e ndjeshme, po unë e cilësoj mjaft të rëndësishme, është me diskutu për temën e Flakadanit të Karadakut. Unë e di që kjo temë prej fillimit ka pas ankesa ose ka pas mosknaqësi prej familjeve tjera të dëshmorëve, edhe unë nuk jam këtu me i përfaqësua dikan personalisht ndaras. Unë nuk jam këtu me ba përçarje, unë personalisht nuk është që kam dikan prej familjeve të dëshmorëve shumë të afër. Unë mendoj që të gjithë dëshmorët naj kanë dhanë atë që kanë pas mundësi më së shumti jetën, e cila është më e vlefshme edhe pse mos mu vendos në diskutim në kuvend, sepse kuvendi e ka miratu edhe mu bë një ndryshim, me i respektu të gjithë familjet e dëshmorëve, pasi që veç ekziston “Flakadani i Karadakut”, pse mos të bëhet flakadanët e karadakut, pse mos të respektohen të gjithë familjet e dëshmorëve njësoj në Komunën e Vitisë, prandaj unë kisha kërkun ju prej saj mu bë një përçarje jo prej saj mu kërkun keqinterpretim, jo prej kësaj me dal që Liridona po kërkun dikë me e favorizu e dikë me e nënëqmu, kapsulat nuk jam kundër kësaj, thjesht po mendoj që ka ardh koha mu vendos një barazi, dikush duhet me e marr flamurin me i hi kësaj pune. Nuk besoj që dikush është kundër kësaj. Ndoshta edhe nuk merremi vesh, po unë mendoj të paktën me marr një nismë, sepse po kalojnë 20 vite. Ky është mendimi im, nuk po du mu keqintepretu kjo. Mendoj që duhet mu be një drejtësi për krejt dëshmorët.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Ke hap dy çështje. Çështja e komisioni për emërtimin e rrugëve. Kjo

bëhet, po duhet me pas kërkesë nga sektori i rrugëve, që me ditë cilët janë rrugët për emërtim dhe duhet me ditë a ka kalu koha që kemi të drejtë me i shqyrtu ankesat. Ndërsa tek çështja e flakadanit, është çështje statutare, kjo rregullohet me statut, e ku në statut nuk shkruan 6 ditë, po aty shkruan 26 Marsi Flakadani i Karadakut. Në në statut e kemi një ditë feste. Kur ta ndryshojmë statutin muj me e hek krejt me e ndryshu, po aty në statut është një ditë. Nuk është çështja e kuvendit po e statudit.

**z. Ilir Zuka:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Punët që po i kemi nga niveli qendror e që po stërgjatën duke u nis nga ndërtimi i palestrës, objekti i zjarrfikëseve, shkolla në Pozharan, stadiumi i Pozharanit, të gjitha projektet të nivelit qendror po stërgjatën punimet. Tash kam informacione që edhe stadiumi në Pozharan që ka pas mu kompletu, operatori ka kërku me e dorëzu pa rregullimin e tribunës. A duhet mu marr dikush me shumë me këtë punë? Unë besoj që po, sepse që katër vite është tu punu në stadium të Pozharanit edhe nuk po përfundon në mënyrë si është në projekt. Si u lejohet një kompanie me bë dorëzimin e punës nëse nuk e ban si në projekt. Këtë që i ceka, krejt kanë fillu, tu fillu nga vitit 2015, 2016, 2017. Unë e kam ngrit edhe me herët çështjen që e ceki Liridona. A beson që, sa telefonatën e kam pas tu më thanë, kush je ti me ngrit këtë shqetësim. Unë kur kam pas cek këtë çështje kam pas marr mendimin e të gjitha familjeve të dëshmorëve. Edhe një shqetësim tjetër, te Zyra e Informimit. Dje kam diskutu me zyrtarin e informimit, pasqyra e komunës është në hapje, kur të del lajmi, a ka mundësi si ekzekutiv me jav ble një aparat, se fotografitë që po postohet, fotot janë jokualitative.

**z. Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Te “Flakdani i Karadakut”, janë dy shoqata. Unë nuk kam kërkesë prej Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve dhe Shoqatës së Veteranëve të Luftës. E para kërkesë zyrtare që vjen për këtë çështje, duhet me ardh në mënyrë institucionale nga këta. Me shku individualisht nuk muj me dal as unë as ti. Unë po thamë duhet me pas vij institucionale, me ardh përmes shoqatave që me e shqyrtu edhe ne.

**z. Ramadan Deliu:** Unë mendoj që duhet me pru vendim, që mos me ndryshu asnjë rrugë.

**z. Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Çështja që u ngrit nga këshilltarët, “Flakadani i Karadakut”, individualisht, krejt kur t’i pyet e mendojnë këtë që po e thuani ju. Kryesuesi po kërkon aspektin zyrtar, që do të ishte shumë më e mirë. Nga përvoja e jonë, mendimi i të gjithëve është kjo. Çka po thuni ju, unë kam fillu këtë para tetë vite, nuk kam mujt me has në mirëkuptim, e kemi fillu përmes Kaltrinës, tu mëndu që është vajza e dëshmorit, po as ajo nuk ka muj. Po unë mendoj që kuvendi është kompetent me statut dhe ju do ta keni para juve, e nëse ju jeni njëzëri në kuvend kur te behet ndryshim plotësimi i statut, behet kjo, sepse po shihet që ka fillu me u zbe mos pjesëmarrja e familjeve te tjera të dëshmorëve. Çështja e komisionit për emërtimin e rrugëve, do te jetë një komision profesionale. Do të shikojmë edhe tek Zyra për Informim, që ta kenë një aparat. Javën e kalume, me kërkesën e kryetarit janë thirr të gjitha kompanitë që janë tu punu në objektet që i ceku Iliri, palestra e stadiumi i Pozharanit e të tjerë, të gjithë ata që i kanë pas kontratat dy e trevjeçare, nuk i vazhdojnë punimet, desh shtine në listë të zezë, sepse ka ndodh një rrethanë e cila nuk është parapa në kontratë, sepse kanë hyp çmimet e të gjithëve. Ju kemi drejtu ministrisë ne për këtë, po presim përgjigjen.

**z. Ilir Zuka:** Neve po na shqetëson, që investitori ka bë kërkesë me e dorëzu projektin pa e përfundu siç është në projekt. D.m.th pa i përfundu shkallët e stadiumit.

**Kryesuesi, z. Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për këtë mbledhje kemi këtë:

## **R e n d i t e**

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katër e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2023-2025.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetori të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2022.**

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore për vitin 2022.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për shqyrtimin dhe aprovimin e kodit të etikës për zyrtaret e Komunës së Vitisë.
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit.
9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** A ka diskutim lidhur me këtë? Pasi që nuk ka, e qes në votim për miratim. Me votat e të gjithëve u miratu rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

### 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katër e Komitetit për Politikë dhe Financa

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi qe nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu procesverbali.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

### 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2023-2025

**z.Besnik Imeri, drejtor i financave:** Përshëndetje te nderuar të pranishëm! Kemi përgatitur KAB-in, e cila miratohet në kuvend komunal. KAB është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve KAB 2023-2025 e përpiluar nga Qeveria e Kosovës në faqe nr. 9 kemi te hyrat komunale dhe parashikim afatmesëm 2023-2025. Buxheti i Komunës së Vitisë përbehet nga dy burime kryesore, grandet qeveritare me 92.9% dhe të hyrat vetanake komunale me 7.10%. Materialin e keni marr me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Te qeto zvogëlimi i grandit ne arsim: a janë tek numri i vendeve te punës? Dhe hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Besnik Imeri, drejtor i financave:** Numri i mësimdhënësve që ka mu zvoglu është ky zvogëlim i buxhetit.

**znj.Liridona Bislimi:** Sa i përket KAB-it, e dimë që është një dokument mjaft me rëndësi, e që lidhet me prioritetet e komunës. Unë si këshilltarë komunal këtë dokument e shof thuaja qe 5 vite, po thamë me bindje të plotë qe nuk ka ndryshu asgjë, është e njëjta. Ajo çka po du me disku, duhet mu cek që, Qeveria ka caktu disa objektiva, ku ky dokument është hartu bazuar në ato objektiva, e të cilat nuk janë cek në këtë dokument. Pyetja është se, tatimi ne pronë është kompetencë komunale. Pyetja është: çfarë masa kanë mu ndërmarr, ashtu që të hyrat të rriten? Cila është forma qe duhet mu rrit te hyrat. Në dokument po e shof një rritje të subvencioneve kapitale. Tek Zyra e Kryetarit ka parashikim të rritjes a do te reflekton kjo tek bursat për studentë. Si mund të quhet planifikim, kur nuk e dimë orientimin buxhetor a është uji, a arsimi, apo shëndetësia. Në këtë dokument po thuhet qe pas dëgjimeve buxhetore. Po unë ta thamë me bindje që nuk janë, se dëgjimet buxhetore merren parasysh tu fillu nga fshati ku vij unë. Asnjëherë nuk janë marr parasysh dëgjimet buxhetore konkrete. Kemi persona të punësuar me kontratë mbi vepër. Tek investimet më intereson ta di, kemi pranë kërkesa të shumta nga qytetarët për rregullimin e disa rrugëve e të cilat nuk janë rregullu. P.sh.: rruga në fshatin Mjak, “17 Shkurti” në Skifteraj, Rruga “Avdullah Emini” në fshatin Lubisht etj. A janë këto rrugë në planifikim tani.

**z.Besnik Imeri, drejtor i financave:** Kur është marr vendimi nga qeveria për me hek kushtëzimin për regjistrimin e veturave, nuk e kanë pa si komponent komunal dhe nuk na kanë pyet komunave hiq. Ne i kemi dy mundësi me i rrit te hyrat komunale, përmes sensibilizimit dhe përmes përbarimit të lëndëve të cilët edhe

jemi ne përgatitje te listave për përmbarim. Dëgjimet buxhetore ende nuk ja kemi fillu, duhet ditën në vijim me fillu me dëgjime buxhetore. Bursat kanë mu ngrit, për atë edhe është bërë rritja e buxhetit.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Liridona e tha, korniza buxhetore po na vjen e njëjtë. Unë pajtohem se, pjesa dërmuese, po ama çka është më rendësi të shifrat ndryshojnë çdo vit. Unë po thamë të fokusohemi tek vitit 2023, sepse viti 2024-2025 mundet me ndryshu. Kërkoje me qenë me detaje. KAB besoj që me buxhet edhe kanë mu detaju. Rruga e Mjakut e thave, unë e di që ti e din që ajo rrugë ka qenë projekt i Qeverisë, e ku mendoj që ju duhet me shfrytëzu. Tani aspekti politik me shpejtua atë, e thave keni kontrata vepër ne arsim. Unë po thamë që në arsim nuk kemi, mundet me pas në çerdhe, ama profesor me kontrata ne vepër nuk ka. “17 Shkurti” mundet me qenë në projekt zëri i qytetarëve, duhet mu dëgju. Nuk ka lokalitet që nuk ka kërkesa, po nuk mundet të realizohen të gjitha për njëherë. Uji do të jetë prioritet, a do ta kemi temë të lehtë jo, po prioritet do të jetë. Unë e kam problem me CDI-në. Nëse e përjashtoj këtë do te hecim me sigurt, po ekziston një marrëveshje ndërmjet CDI dhe ministrisë, që ne nuk mujmë të ndikomi këtu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që të shkon për kuvend kjo pikë e rendit të ditës? Me votat e të gjithëve shkon në kuvend.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

**3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetori të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Bazuar ne planin e punës se kuvendit, ju kemi propozu këtë grup punues. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2022**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore për vitin 2022**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

**7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për shqyrtimin dhe aprovimin e kodit të etikës për zyrtarët e Komunës së Vitisë**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Duhet me pas një kod të etikës për shërbyesit civil. Një grup punues e ka përgatit. Këtë material e keni para vete. Për pyetje shtesë, urdhëroni.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Illir Zuka:** Unë mendoj që një nder pikat me kryesore është kjo, sepse mendoj që duhet mu ditë punëtori komunal. Po e pyes nënkryetari, se si është mundësia që edhe shkollat, d.m.th arsimit me e pas këtë. Besoni që

kam informacione se një prej mësuesve ka shku me traktor me pres ka hi e ka mbajt një ore edhe me shpejt me dal me lidh san. Kjo ka ndodh në Komunën e Vitisë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar:** Me vjen keq kjo qe paska ndodhe. Kur kam qenë unë në shkollë të mesme, profesorët nuk kanë pas shancë me ardh as me farmerka në punë. Unë edhe ne fakultet kur kam pas provime, nuk kam shku me maica e me pantolla framerakë, po jam shku me këmishë. Megjithatë ky kod është për shërbyesit civil.

**z.Besnik Imeri, drejtor;** Unë kam në drejtorinë time punëtor që i merr 370 euro edhe mban familje. E ne me i kufizu në veshje, nuk po me doket në rregull ose duhet me pas parasysh edhe anën ekonomike.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mësimdhënësit e kanë uniformën, e besoj qe e respektojnë këtë. Po prapë mendoj qe duhet me pas një kod të veshjes. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

#### **8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit**

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Përhëndetje për të gjithë! E kemi kërkesën për me i marr në shfrytëzim. Kjo ka të bëjë në fshatin Devaj, ku e kemi një plan të biznesit, i cili ish shumë mirë i përgatitur dhe kërkoj që të ju jepet mundësia me investu këtu.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të nëntë të rendit të ditës kemi:

#### **9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit**

Drejtoresha, znj.Majlinda Ostergllava bënë prezantimin e kësaj pike të rendit të ditës.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë mbledhje të KPF-së. Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Bekim Azizi**

---